

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i përgjithshëm**, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari Ahmet Idrizaj - Kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve porotë Ismet Këndusi dhe Fahredin Meqa – anëtar të trupit gjykues, në çështjen juridiko-civile të paditëses L. M. A. nga T. tani me vendbanim të përkohshëm në Rr. “. . . ” pa nr. – S. “. . . ” në Gjakovë, kundër të paditurit A. B. F. me banim në lagjen B., Rr. ... pa nr. – Gjakovë, për besim, ruajtje, mbajtje dhe edukim të fëmijëve, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor jo publik, të mbajtur me datë 14.01.2019, në prezencë të paditëses dhe në mungesë të të paditurit, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Fëmijët e mitur të përbashkët të palëve në procedurë E. A. F., data e lindjes . . . , në Gjakovë, Sh. A. F. data e lindjes . . . , në Gjakovë dhe B. A. F. data e lindjes . . . , në Gjakovë, i besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim nënës së tyre L. M. A. nga T. tani me vendbanim të përkohshëm në Gjakovë, ashtu që detyrohet i padituri A. B. F. nga Gjakova, që t’ia njohë këtë të drejtë paditëses në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

**CAKTOHET** kontakti personal i të paditurit A. B. F. nga Gjakova, me fëmijët e mitur E. A. F., data e lindjes . . . , Sh. A. F., data e lindjes . . . dhe B. A. F., data e lindjes . . . , të premtën e parë të çdo muaji nga ora 14:00/h deri në ora 15:00/h, ashtu që ky kontakt realizohet nën mbikëqyrjen e nëpunësit për punë sociale në lokalet e Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë dhe **DETYROHET** paditësja L. M. A. nga T. tani me vendbanim të përkohshëm në Gjakovë, që të miturit e lartë përmendur, të i sjellë në lokalet e Qendrës për Punë Sociale, ditët dhe në kohët e caktuara si më sipër, e nën kërcënim të përmbarrimit.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### A r s y e t i m

Paditësja në këtë gjykatë me datë . . . , ka parashtruar padi kundër të paditurit të lartpërmendur, për besimin, edukimin, ruajtjen dhe mbajtjen e fëmijëve të përbashkët të palëve në procedurë. Me tej ka potencuar faktin se me datë . . . ka hyrë në marrëdhënie jashtëmartesore me të paditurin e lartpërmendur. Jeta e përbashkët e tyre është bërë e padurueshme dhe me ç’rregullime serioze me ç’rast e paditura me datë . . . është detyruar me dhunë, që të e lëshojë shtëpinë e të paditurit dhe të strehohet në Sh. e s. – Gjakovë. Nga kjo bashkësi jashtëmartesore palëve në procedurë iu kanë lindur fëmijët e tyre të përbashkët E. A. F., data e lindjes . . . , Sh. A. F. data e lindjes . . . , dhe B. A. F. data e lindjes . . . , të cilët janë në përkujdesje të këtu paditëses. I padituri ka kontakt të herëpashershëm me fëmijët e lartpërmendur, të cilat kontakte i njëjti i ka realizuar në Qendrën për Punë Sociale në Gjakovë, e për shkak të rrethanave të krijuara pas situatës faktike që ekziston mes palëve ndërgjyqëse, të njëjtit nuk kanë arritur ndonjë marrëveshje adekuate lidhur me kontaktin e fëmijëve.

Paditësja në fjalën e saj përfundimtare deklarojë se: nga provat e zbatuara në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar themelësia e kërkesëpadisë. Ashtu që i propozojë gjykatës që kërkesëpadia si në petitumin e referatit të padisë, të miratohet në tërësi si e themeltë. Sa i përket çështjes së alimentacionit për fëmijë, do të parashtrrojë padi të veçantë, shkakun se tani për tani nuk ka llogari bankare në asnjërin nga bankat në Kosovë – shkakun edhe i skadimit të afatit të LNJ-së.

Nuk kërkojë shpenzime procedurale.

Gjykata në mbështetje të nenit 423 par. 4, të LPK-së, shqyrtimin kryesor, e mbajti në mungesë të të paditurit të ftuar në mënyrë të rregullt (i cili nuk ka parashtruar as përgjigje në padi edhe përkundër faktit se me kohë i është dërguar aktvendimi për dhënien e përgjigjes së detyrueshme në padi, padia dhe provat materiale), me ç'rast pas vlerësimit të fakteve - juridike relevante, çmuarjes me ndërgjegje të provave të zbatuara dhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit, e në pajtim me nenin 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e themeltë dhe si e tillë u miratua.

Nga provat e zbatuara është argumentuar gjendja faktike si në vijim:

Nga Ekstrakt i Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile Nr. E ... i lëshuar me datë ...në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë, vërtetohet se fëmija i përbashkët i palëve në procedurë E. A. F., data e lindjes . . . , në Gjakovë, nga nëna L. A.– paditësja dhe babai A. F.– i padituri.

Nga Ekstrakt i Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile Nr. E . . . i lëshuar me datë ...në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë, vërtetohet se fëmija i përbashkët i palëve në procedurë Sh. A. F., data e lindjes . . . , në Gjakovë, nga nëna L. A.– paditësja dhe babai A. F.– i padituri.

Nga Ekstrakt i Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile Nr. E . . . i lëshuar me datë ...në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë, vërtetohet se fëmija i përbashkët i palëve në procedurë B. A. F., data e lindjes . . . , në Gjakovë, nga nëna L. A.– paditësja dhe babai A. F.– i padituri.

Nga Vërtetim nr. . . . i datës . . . , i lëshuar nga Sh. e S. në Gjakovë, vërtetohet se paditësja L. M. A. së bashku me fëmijët e saj të lartpërmendur është strehuar në strehimoren e Shtëpisë së Sigurt në Gjakovë, me datë . . . , si rast i dhunës së shkaktuar në familje nga ana e të paditurit, i cili rast është i referuar edhe nga Policia e Kosovës - Gjakovë.

Nga Raporti i Qendrës për Punë Sociale - Organi i Kujdestarisë në Gjakovë, nën nr. punues . . . , i datës 02.11.2018, është vërtetuar se : Bashkësia jashtëmartesore e bashkëshortëve ka filluar në vitin 2013 dhe nga e njëjta bashkësi jashtëmartesore, palëve iu kanë lindur fëmijët e përbashkët të lartpërmendur. Palët ndërgjyqëse përfundimisht e kanë shkëputur bashkësinë faktike jashtëmartesore në muajin janar të vitit 2018, për shkak të jetës së padurueshme dhe nga ajo kohë e tutje e paditura, jeton në strehimoren e Shtëpisë së Sigurt në Gjakovë, së bashku me fëmijët e lartpërmendur, ndërsa i padituri jeton në lokalitetin B. në Rr. ....– përkatësisht shtëpinë e tij. Organi i lartcitur i kujdestarisë, duke u bazuar në rrethanat e krijuara dhe duke marrë parasysh edhe moshën e fëmijëve, të cilët kanë më së shumti nevojë për nënën e tyre, e cila është duke u përkujdesur për të njëjtit, në mënyrë të vazhdueshme, ka dhënë mendimin se është në interesin më të lartë të fëmijëve që edhe tani e tutje, të njëjtit të mbesin në ruajtje, mbajtje dhe edukim të nënës së tyre – paditëses në rastin konkret.

Sa i përket çështjes së besimit, mbajtjes dhe edukimit të fëmijëve të përbashkët të palëve në procedurë E. A. F., data e lindjes . . . , Sh. A. F., i lindur me datë . . . dhe B. A. F., data e lindjes . . . si dhe duke pasur parasysh faktin se të njëjtit janë duke jetuar më nënën e tyre, këtu paditësen në rastin konkret, rezulton se paditësja me fëmijët e përbashkët të palëve në procedurë, është më tepër e lidhur emocionalisht me të njëjtit, ashtu sikundër edhe fëmijët janë të lidhur emocionalisht mes veti dhe duke marrë parasysh edhe raportin e sipërcitur të Qendrës Për Punë Sociale – Organi i Kujdestarisë në Gjakovë, rezulton se është në interesin më të mirë të fëmijëve të përbashkët të palëve në procedurë, që të njëjtit edhe tani e tutje, të mbesin nën përkujdesjen, ushqimin, ruajtjen, mbajtjen dhe edukimin e këtu paditëses – nënës së tyre. Ky qëndrim i gjykatës gjenë mbështetje edhe në dispozitën ligjore të nenit 139 parag.2 të Ligjit për Familjen i Kosovës (Ligji nr.2004/32) dhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve, për çka u vendos si në pikën I-të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Sa i përket çështje së kontaktit të fëmijëve të përbashkët të palëve në procedurë dhe duke pasur parasysh faktin se të njëjtiat kontakte të fëmijëve me prindin të cilit nuk i janë besuar në rastin konkret me të paditurin, është në interesin më të mirë të fëmijëve që të kenë kontakte me të dy prindërit, në

mënyrë që të ketë një rritje sa më të mirë dhe duke u mbështetur edhe në dispozitën ligjore të nenit 140 par. 3 të LFK-së, të para cituar, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi (pavarësisht nga fakti se pala aktive në procedurë deklarojë se nuk do të ketë problem rreth çështjes së kontaktit të prindit – te i cili fëmijët nuk ndodhen).

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 450 të LPK-së dhe deklarimit të paditëses e cila pati sukses në procedurë, mirëpo të njëjtat nuk i kërkojë.

Nga të lartë cituarat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**C.nr.595/2018 datë 14.01.2019**

**KRYETARI I TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTARI,**  
**Ahmet Idrizaj**

**UDHËZIM JURIDIK;** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.